

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE 2025

Lënda: Ekonomi

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim dhe arsytim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7
Pikët							
Kërkesa	8	9	10	11	12	13	14
Pikët							
Kërkesa	15	16	17	18	19	20	21
Pikët							
Kërkesa	22	23	24	25	26	27	28
Pikët							
Kërkesa	29	30	31	32	33		
Pikët							

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Ejona gjatë një muaji kurseu 20000 lekë. Ejona kuptoi që me to mund të blinte parfumin e saj të preferuar ose një palë atlete. Ajo vendosi t'i shpenzonte paratë e kursyera për të blerë parfumin. Kosto oportune e zgjedhjes së Ejonës në këtë rast është:

1 pikë

- A) zero.
- B) 20000 lekë.
- C) një palë atlete.
- D) parfumi i preferuar.

2. Para vitit 1990 në Shqipëri aplikohesh sistemi i komanduar i ekonomisë. Mjetet e prodhimit në këtë sistem ekonomik ishin në pronësi të:

1 pikë

- A) konsumatorit.
- B) biznesit.
- C) qeverisë.
- D) familjes.

3. Cila prej alternativave të mëposhtme **nuk** përfaqëson të ardhura nga pasuria?

1 pikë

- A) Martini mori 50000 lekë nga dhënia me qira e një apartamenti.
- B) Genti mori 80000 lekë dividend nga aksionet që zotëron në kompaninë X.
- C) Albana mori 3000 lekë interesa nga llogaria bankare e kursimit.
- D) Mira mori pagën prej 120000 lekë nga puna si ekonomiste.

4. Një përmirësim teknologjik brenda vendit në industrinë e prodhimit të produkteve ushqimore do të çonte në:

1 pikë

- A) rritje të kërkesës për produktet ushqimore.
- B) rritje të ofertës për produktet ushqimore.
- C) ulje të kërkesës për produktet ushqimore.
- D) ulje të ofertës për produktet ushqimore.

5. Një rritje në çmimin e pijeve freskuese në masën 10% çoi në rënie të sasisë së kërkuar në masën 2%. Në këtë rast mund të themi se:

1 pikë


- A) $E_d=2$ dhe kërkesa është elastike.
- B) $E_d=0.2$ dhe kërkesa është elastike.
- C) $E_d=5$ dhe kërkesa është elastike.
- D) $E_d=0.2$ dhe kërkesa është joelastike.

6. Familja e Adriatikut përbëhet nga katër anëtarë, babai, nëna dhe vëllai. Babai ka një pagë prej 90 000 lekë në muaj, mamaja një pagë prej 80 000 lekë në muaj. Ata zotërojnë një apartament me vlerë 9 000 000 lekë dhe një depozitë kursimi me vlerë 2 000 000 lekë, nga e cila marrin një interes mujor prej 6 000 lekë në muaj. Gjenerali sa janë të ardhurat në muaj, nga pasuria për familjen e Adriatikut?

1 pikë

- A) 6 000 lekë.
- B) 170 000 lekë.
- C) 2 000 000 lekë.
- D) 9 000 000 lekë.

7. Duke parë me vëmendje paraqitjen grafike të mëposhtme, cila prej alternativave pasqyron saktë ndryshimin në ekuilibrin e tregut? **1 pikë**



- A) Oferta është ulur si pasojë çmimi është rritur.
- B) Oferta është ulur si pasojë çmimi është ulur.
- C) Kërkesa është rritur si pasojë çmimi është rritur.
- D) Kërkesa është ulur si pasojë çmimi është rritur.

8. Kur norma e inflacionit është në nivelin e 30%, themi se kemi të bëjmë me: **1 pikë**

- A) hiperinflacion.
- B) deflacion.
- C) inflacion galopant.
- D) inflacion të moderuar.

9. Në një ekonomi, çmimet e mallrave dhe shërbimeve bien vazhdimisht për disa muaj. Konsumatorët shtyjnë blerjet duke pritur që çmimet të bien edhe më shumë dhe bizneset reduktojnë investimet për shkak të rënies së kërkesës. Cili fenomen ekonomik përshkruhet më së miri nga kjo situatë? **1 pikë**

- A) Inflacioni.
- B) Stagflacioni.
- C) Deflacioni.
- D) Rritja ekonomike.

10. Si rezultat i mbylljes së disa fabrikave për shkak të rënies ekonomike, shumë persona kanë humbur punën në sektorin e industrisë. Çfarë lloj papunësie mund të karakterizojë këtë situatë? **1 pikë**

- A) Papunësi strukturore, që ndodh kur ka një shkëputje mes aftësive të punëtorëve dhe kërkesës për aftësi të reja në tregun e punës.
- B) Papunësi sezonale, e shkaktuar nga ndryshimet në kërkesën për punë gjatë stinëve të vitit.
- C) Papunësi friksionale, që ndodh kur punëtorët refuzojnë të punojnë në pozita që nuk i përshtaten dëshirave të tyre.
- D) Papunësi ciklike, e shkaktuar nga periudhat e krizës ekonomike që çojnë në rënie të kërkesës për punë.

11. Ina bleu pajisje elektroshtëpiake për të kompletuar apartamentin e ri, me kredi konsumatore. Cili prej formulimeve të mëposhtme **nuk** është i saktë për përdorimin e kredisë? **1 pikë**

- A) Zotëron menjëherë produktet që dëshiron.
- B) Blen me kosto më të ulët.
- C) Procedura më të gjatë të blerjeve.
- D) Blen me kosto më të lartë.

12. Gjatë krizës globale të vitit 2008, ekonomia greke përjetoi një ngadalësim të ndjeshëm dhe vendi u përball me sfida, si ulja e investimeve të huaja dhe dobësimi i konsumit. Cila fazë e ciklit të biznesit përshkruan më së miri këtë periudhë? **1 pikë**
- A) Zhvillimi ekonomik.
B) Rritja ekonomike.
C) Piku.
D) Rënia ekonomike.
13. Cili është efekti i një norme të lartë të tarifave doganore në tregtinë ndërkombëtare? **1 pikë**
- A) Rrit konkurrencën dhe zvogëlon çmimet për konsumatorët.
B) Pengon importet dhe rrit çmimet për konsumatorët.
C) Zgjeron tregun për produktet e huaja.
D) Zvogëlon pasigurinë për tregtarët ndërkombëtarë.
14. Cila nga situatat e mëposhtme përfaqëson një nga qëllimet kryesore të menaxhimit të financave personale? **1 pikë**
- A) Të shpenzosh pa kursim të ardhurat mujore.
B) Të huazosh vazhdimisht para nga bankat.
C) Të bësh investime pa bërë planifikim financiar.
D) Të kursesh një pjesë të të ardhurave për të investuar në të ardhmen.
15. Cila nga situatat e mëposhtme përfaqëson një shembull të një dileme etike në fushën e shëndetësisë? **1 pikë**
- A) Përdorimi i informacionit mjekësor të pacientëve për qëllime kërkimore edhe pse me pëlqimin e tyre.
B) Trajtimi i pacientëve në përputhje të plotë me të drejtën e tyre për vetëvendosje, siç përcakton ligji.
C) Përdorimi i mjekësisë alternative edhe kur nuk ka prova shkencore të efikasitetit të saj.
D) Ofrimi i shërbimeve shëndetësore cilësore dhe me kosto të ulët.
16. Aldi dhe Enesi janë punonjësit më të rinj të një kompanie marketingu. Të dyve ju duhet të punojnë së bashku në funksion të arritjes së një zgjidhje më të mirë nga zgjidhja që do të mund të arrinte secili individualisht. Kjo aftësi e tyre njihet ndryshe si: **1 pikë**
- A) aftësi e transferueshme.
B) talent ose kompetencë.
C) sinergji.
D) të menduarit në variantin të fitojnë të gjitha palët.
17. Burimet kryesore të të ardhurave si fonde financiare të brendshme në një korporatë vijnë nga: **1 pikë**
- A) fitimet e korporatës.
B) letrat me vlerë.
C) kreditë tregtare.
D) kreditë bankare afatshkurtra.
18. Përgjegjësia e pakufizuar është karakteristikë e: **1 pikë**
- A) firmës individuale dhe korporatës.
B) korporatës dhe firmës me ortak.
C) firmës individuale dhe me ortak.
D) korporatës, por jo firmës individuale.

19. Plani financiar i qeverisë që përmban të ardhurat dhe shpenzimet e saj për një periudhë 1 vjeçare quhet:

1 pikë

- A) planifikim ekonomik.
- B) taksim.
- C) deficit buxhetor.
- D) buxhet qeveritar.

20. Nga alternativat e mëposhtme, cila paraqet një të ardhur qeveritare?

1 pikë

- A) Taksa mbi të ardhurat nga një dyqan i dhënë në përdorim.
- B) Pagat e mësueseve në një shkollë publike.
- C) Blerja e sinjalistikës së re rrugore.
- D) Investimet e qeverisë për ndërtimin e një rruge të re.

21. Tabela e mëposhtme shpreh kufirin e mundësive të prodhimit për një vend të caktuar.

2 pikë

Mundësitë	Grurë (tonë)	Veshje (mijë)
A	0	30
B	1	28
C	2	24
D	3	18
E	4	10
F	5	0

Në qoftë se vendi realizon kombinimin G (1:20) që korrespondon poshtë kufirit të mundësive të prodhimit, çfarë mund të themi për burimet ekonomike?

Në qoftë se vendi dëshiron kombinimin N (3:25) që korrespondon sipër kufirit të mundësive të prodhimit, çfarë mund të themi për burimet ekonomike?

22. Në një hotel me kapacitet prej 50 dhomash, kur çmimi i shërbimit të akomodimit u rrit në masën 20 %, sasia e kërkuar ul me 15%, ndërsa sasia e ofruar nuk ndryshoi.

3 pikë

Llogaritni elasticitetin e kërkesës.

Llogaritni elasticitetin e ofertës.

Çfarë mund të themi për elasticitetin e ofertës në këtë rast?

23. Erta dhe Klajdi janë dy të rinj që kanë vendosur të hapin një biznes të ri, një kafene moderne që përdor teknologji për të përmirësuar përvojën e klientëve. Ata kanë një ide novatore: klientët mund të porosisin dhe të personalizojnë pijet e tyre përmes një aplikacioni dhe të marrin një shërbim të shpejtë. Analizoni tri aftësi që mendoni se janë më të rëndësishme për Ertën dhe Klajdin për të pasur sukses në biznesin e tyre? **3 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____

24. Tabela e mëposhtme tregon kërkesën dhe ofertën për motorë në një pikë shitjeje.

4 pikë

Çmimi (euro)	Sasia e kërkuar	Sasia e ofruar
3000	70	30
3200	60	40
3300	50	50
3400	40	60
3500	30	70
3600	20	80

Përcaktoni sa është sasia ekuilibër?

Përcaktoni sa është çmimi ekuilibër?

Supozojmë se në treg hyjnë mjete të tjera zëvendësues me çmim më të ulët, si pasojë sasia e kërkuar e motorëve do të ulet me 20 njësi për çdo nivel çmimi. Përcaktoni çmimin e ri ekuilibër.

Paraqiteni situatën grafiksht.

25. Duke iu referuar metodës së shpenzimeve në llogaritjen e PBB-së, përcaktoni në cilën kategori përfshihen situatat e mëposhtme? **3 pikë**

Familja e Erit paguan për një kurs online për zhvillimin e aftësive profesionale të saj.

Arba bleu një apartament të ndërtuar këtë vit nga një kompani ndërtimi vendase.

Qeveria financon një projekt kërkimi shkencor mbi energjinë e rinovueshme.

26. Një vend po përballlet me një periudhë recesioni ekonomik, ku rritja e produktit të brendshëm bruto është shumë e ulët. Për të stimuluar aktivitetin ekonomik Banka Qendrore ka vendosur të ulë normat e interesit të huave për të inkurajuar huamarrjen dhe investimet.
Duke analizuar situatën e mësipërme, gjeni: **3 pikë**

a) me çfarë politike kemi të bëjmë në këtë situatë?

b) cili do të jetë ndikimi i kësaj politike mbi ofertën monetare?

c) cili do të jetë ndikimi i kësaj politike në lidhje me papunësinë?

27. Albani është financier i ri dhe do të ndërtojë bilancin e firmës ku ai është punësuar si ekonomist: **3 pikë**

Para	40 000
Inventare	90 000
Pagesa për t'u kryer	40 000
Detyrime rrjedhëse	20 000
Makineri	250 000
Ndërtesa	200 000
Obligacione	200 000

a) paraqitni barazimin kontabël për hartimin e bilancit.

b) llogaritni, sa është vlera e aktivit?

c) llogaritni, sa është vlera neto e firmës?

28. Kosto fikse (TFC) e një firme për një vit është 100.000 lekë, ndërsa kosto e ndryshueshme për njësi të prodhuara (AVC) është 200 lekë. Nëse firma parashikon të prodhojë gjatë këtij viti 1.000 njësi produkt dhe çmimi për çdo njësi produkti do të ishte 400 lekë llogaritni: **4 pikë**

a) sa është kosto e përgjithshme për çdo njësi të prodhuar (ATC)?

b) sa është kosto totale e përgjithshme (TC)?

c) sa është kosto mesatare fikse (AFC)?

d) për këtë sasi produkti, sa do të ishte fitimi i firmës?

29. Arbi ka hapur një dyqan për shitjen e produkteve të kujdesit për lëkurën në një lagje ku tashmë operojnë dy biznese në këtë fushë. Konkurrentët e tij shesin produkte të njohura dhe ofrojnë shpesh ulje të çmimeve, duke tërhequr shumicën e klientëve. Shpjegoni tri avantazhe konkurruese të krijimit të një linje produktesh të personalizuar dhe organike që do ta ndihmonin Arbin të ketë sukses në raport me konkurrentët e tij. **3 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____

30. Tabela e mëposhtme na tregon një firmë që vepron në kushtet e konkurrencës së plotë në tregun e produkteve bujqësore dhe e shet produktin me çmim $P=80$ lek/kg. Kosto totale fikse është $TFC=400$ lekë. Kosto totale e ndryshueshme paraqitet në tabelën e mëposhtme. Bazuar në të dhënat e tabelës: **3 pikë**

Q	1	2	3	4	5	6	7	8
TVC	60	70	100	140	200	280	390	510

a) përcaktoni kushtin që duhet të plotësojë firma për të gjetur sasinë optimale të produktit që duhet të prodhojë.

b) llogaritni, sa është sasia optimale e produktit që duhet të prodhojë firma me qëllim që të maksimizojë fitimin?

c) llogaritni, sa është fitimi ose humbja e firmës për këtë sasi optimale?

31. Tabela e mëposhtme na jep një firmë që vepron në konkurrencë të plotë si në tregjet e produkteve dhe në tregun e punës. Nëse çmimi i produktit është 10 njësi paraqe dhe paga 30 njësi paraqe: **3 pikë**

L	TPP
0	0
1	10
2	15
3	18
4	20
5	21

a) llogaritni, sa është sasia optimale e punës që do të blejë firma me qëllim që të maksimizojë fitimin?

b) llogaritni, sa është kosto totale e punës kur firma ka punësuar 5 punëtorë?

c) përcaktoni kushtin që firma nuk duhet të vazhdojë të punësojë punëtorë.

32. Përcaktoni llojin e taksës në situatat e mëposhtme.

3 pikë

a) Artani dhe Iliri edhe pse të ardhurat nga puna i kanë të ndryshme, paguajnë 15% të taksës mbi të ardhurat.

b) Albana ka një pagë prej 130.000 lekë në muaj, kurse Fisniku ka një pagë prej 80.000 lekë. Albana paguan një taksë mbi të ardhurat me vlerë 13.000 lekë, ndërsa Fisniku 8.000 lekë.

c) Një familje me të ardhura të ulëta dhe një familje me të ardhura të larta blejnë një lavatriçe me çmim 80.000 lekë dhe paguajnë 20% taksë.

33. Joni është drejtues i një banke të nivelit të dytë që ka për qëllim të zgjerojë dhe të ofrojë shërbime të ndryshme për klientët. Pasi ka kryer një analizë të nevojave të klientëve dhe tendencave të tregut, vendosi që banka të ofrojë shërbime për të përmirësuar dhe rritur konkurrencën në treg. Shpjegoni tre shërbime që mund të ofrojë kjo bankë.

3 pikë

1) _____

2) _____

3) _____